

KLODETA DIBRA



Me pedagogët dhe studentët për një universitet ndryshe

KLODETA DIBRA

**KANDIDATE PËR REKTORE
E
UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

PLATFORMË

PËR NJË UNIVERSITET LIDER

Prill 2016





1-BIOGRAFI E SHKURTËR



Prof. Dr. Klodeta Dibra është diplomuar me rezultate të shkëlqyera në Studime për Filologji Italiane, në vitin 1988, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, të Universitetit të Tiranës. Në vitet 1988-1994 ka punuar si pedagoge në Departamentin e Italianistikës, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë (nga 1993, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja). Gjatë periudhës 1994-2008 ka kryer funksionin e Shefes së Departamentit të Gjuhës Italiane. Në të njëjtën periudhë ka qenë gjithashtu Anëtare e Këshillit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe prej vitit 2003 Anëtare e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës.

Nga viti 2008 dhe deri sot Prof. Dr. Klodeta Dibra ka qenë Dekane e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, si dhe ka shërbyer gjithashtu si Kryetare e Këshillit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe Anëtare e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës.


Prof. Dr. Klodeta Dibra ka një aktivitet shkencor të gjerë, që përfshin pjesëmarrje në konferenca dhe projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Ajo është autore dhe bashkautore në artikuj shkencore, kumtesa, tekste universitare, monografi, tekste shkollorë dhe lëvtron aktivitetin mësimor dhe akademik në fushat e Gjuhësisë dhe Komunikimit. Firmën e saj mbajnë shqipërimi i disa autorëve italianë si: Carmine Abate (Romani “Motoçikleta e Skënderbeut”), Dacia Maraini (Roamani “Moshë e trazuar”, Orianna Fallacci (Romani “Letër fëmijës së palindur kurrë”), Mario Luzi (Përmbledhje me poezi) etj.

Prof. Dr. Klodeta Dibra është nderuar më një numër medaljesh:

- Medalje e Artë në Lojërat Mesdhetare (Siri), 1987
- Urdhri “Naim Frashëri i Klasit II”, dhënë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, 1987
- Titulli “Mjeshtër i Merituar i Sportit”, 1988
- Medalje e Argjendtë në Kupën Promocionale (Maltë), 1996
- Medalje e Artë “Për Merita të Shquara në Fushën e Sportit”, 2002
- Personalitet i Shkencës, Shoqata Tirana, 2005

- Medalje Nderi e Kalorësit, Klasi III – “Ordine della stella solidarieta italiana”, dhënë nga Presidenti i Republikës Italiane Giorgio Napolitano, 2006

2. MBI ÇFARË BINDJESH DHE VLERASH NGRIHET PLATFORMA IME?



Universiteti i Tiranës duhet të përfaqësojë:

- Liderin e gjithë universiteteve në Shqipëri;
- Krenarinë e sistemit shqiptar të universiteteve dhe të arsimit të lartë;
- Tempullin e dijes e të debatit dhe jo vendin e abuzimeve, përfitimeve dhe premtimeve të gënjeshtra dhe të pambajtura;
- Pasurinë tonë si pedagogë dhe studentë, të publikut dhe shoqërisë;
- Një universitet të krahasueshëm në cilësi dhe peshë me universitetet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë.

Universiteti i Tiranës duhet të demonstrojë institucionalisht se:

- Ka në themel bashkëpunimin institucional dhe njerëzor, që udhëhiqet nga integriteti profesional dhe moral, nga respekti për idetë e tjetrit, toleranca, mirëkuptimi, integrimi, qytetaria dhe përkushtimi.
- Funksionon në mënyrë të mirëorganizuar, të hapur, transparente, demokratike dhe jo në mënyrë të mbyllur, nepotike dhe të keq-administruar.

Universiteti i Tiranës duhet të demonstrojë akademikisht se:

- Ofron cilësinë më të mirë të mësimdhënies dhe programeve akademike.
- Ka stafin akademik me profesional dhe me kredenciale akademike në nivelet që kërkon meritokracia dhe konkurrenca, në nivel rajonal e më gjerë.
- Ka studentët më cilësorë e të përkushtuar ndaj dijes dhe mësim nxënies.
- Ofron mundësitë më të mira për studentët dhe pedagogët, në rrugën e tyre të formimit profesional dhe shkencor.

- Është bartës dhe zhvillues i gjallë i debatit, i të menduarit kritik, dhe veprimtarisë kërkimore-shkencore.
- I kushton vëmendje dhe ofron një infrastrukturë fizike dhe virtuale, që reflekton ndryshimet teknologjike, nevojat e studentit dhe pedagogut, nevojat e shoqërisë shqiptare dhe zhvillimet e vendit.

3. PËRSE PLATFORMA IME ËSHTË ALTERNATIVA MË E MIRË?

Së pari, sepse ajo është **ZËDHËNËSE** dhe reflekton shqetësimet e pedagogëve, studentëve dhe të stafit administrativ.

Së dyti, sepse ajo mban në konsideratë dhe e identifikon veten me **INTERESAT** e pedagogëve, studentëve dhe të stafit administrativ.

Së treti, sepse nxit vetëdijen për përgjegjësi të çdo pjesëtari të bashkësisë akademike, studentore dhe administrative.

Së katërti, sepse ajo ofron një **MODEL QEVERISJE** të universitetit, të ndryshëm nga qeverisjet e mëparshme.

Së pesti, sepse modeli i drejtimit të universitetit, që ofron **PLATFORMA** ime:

- **Është realiste**, d.m.th nuk ngrihet mbi gënjeshtër dhe premtime të gjithfarshme, të pamundshme për t'u mbajtur;
- **Synon të rivendosë prestigjin e nëpërkëmbur të Universitetit të Tiranës si universiteti lider**, i cili është i vetmi institucion akademik brenda sistemit të universiteteve dhe arsimit të lartë në Shqipëri që:
 - ✓ Përfaqëson universitetin më të madh në Shqipëri, me 800 pedagogë dhe 25 mijë studentë;
 - ✓ Ka dhe duhet t'i ofrojë shoqërisë, ekonomisë, qeverisjes, institucioneve, sektorit publik dhe privat, potencialin më të madh akademiko-shkencor, që ka ndonjë universitet në Shqipëri;
 - ✓ Duhet të ofrojë ekselencë akademike në mësimdhënie, në kërkim-shkencor dhe në projekte kërkimore dhe aplikative; Ka të gjitha resurset e nevojshme për t'iu përgjigjur sfidave të zhvillimit të teknologjisë, komunikimit, informacionit dhe ekonomisë e tregut.

- Synon të konsolidojë reputacionin e Universitetit të Tiranës si në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar,** duke vënë si

objektiv që Universiteti i Tiranës:

- ✓Të jetë një pikë referimi jo vetëm për universitetet shqiptare të Kosovës dhe Maqedonisë, por për të gjithë rajonin e Ballkanit;
- ✓Të përfaqësojë një universitet cilësor dhe të rëndësishëm brenda rrjetit të universiteteve Europiane;
- ✓Te bëhet i akreditueshëm nga organizata dhe agjenci ndërkombëtare;
- ✓Të përmirësojë vendin shumë të ulët, që zë aktualisht në renditjen e universiteteve, në mënyrë që të zërë një vend prestigjioz, në të gjitha listat që renditin universitetet më të mira.

- Synon të rivendosë dinjitetin dhe prestigjin e pedagogut:**

- ✓Profesional, financiar dhe moral.

- Synon të fuqizojë Universitetin e Tiranës** nga pikëpamja financiare dhe e burimeve njerëzore, përmes:

- ✓Diversifikimit dhe menaxhimit eficient të burimeve financiare;
- ✓Rritjes së studiuar dhe efeciente të numrit të stafit akademik dhe stafit administrativ;
- ✓Diversifikimit të programeve akademike, kërkimit shkencor aplikativ dhe gjallërimit të lidhjeve të tyre me tregun, nevojat e ekonomisë, shoqërisë dhe vendit.

4. CILAT JANË PROBLEMET E DERITANISHME DHE AKTUALE TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS?

Problemet që mban parasysh kjo platformë në orientimin e drejtimit të Universitetit të Tiranës në 4 vitet e ardhshme, si dhe drejtimi i energjive dhe i projekteve drejt zgjidhjes së tyre, kanë të bëjnë me politikat dhe trajtimin e pedagogëve, studentëve, mësimdhënies, programeve akademike, kërkimit shkencor, menaxhimit të burimeve financiare, infrastrukturën, funksionimin administrativ, zhvillimin strategjik dhe profilin ndërkombëtar, si dhe me marrëdhëniet institucionale mes strukturave drejtuese dhe qeverisjes së universitetit.

4.1 Problemet me POLITIKAT dhe TRAJTIMIN E STAFIT AKADEMIK

Në këtë aspekt, kjo platformë mban parasysh përballjen me një numër problemesh të pazgjidhura dhe të trashëguara nga qeverisjet e kaluara të Universitetit të Tiranës:



•**Mungesa e Statusit Akademik të Pedagogut.** Mungesa e këtij statusi i ka lënë pedagogët e thjeshtë të zbuluar para arrogancës së drejtuesve të të gjitha niveleve dhe nën mëshirën e qëndrimeve dhe preferencave subjektive dhe personale. Statusi i pedagogut duhet të mbështetet në kredencialet personale akademike, që e bëjnë pedagogun imun ndaj presionit dhe kontratave të punës së drejtuesve.



•**Problemet me pagat dhe shpërblimet për pedagogët.** Rritja e fundit e pagës së pedagogut është bërë në vitin 2005. Përveç mos rritjes dhe mos indeksimit të pagës, pedagogu është deprivuar edhe nga shpërblimi për të gjithë mbingarkesën akademike, orët suplementare dhe të gjitha aktivitetet e tjera akademike, të planifikuara ose jo.



•**Mungesa e mobilitetit akademik të pedagogëve.** Ndonëse Universiteti i Tiranës e ka formatuar veprimtarinë e vet sipas parimeve të Procesit të Bolonjës, një ndër orientimet kryesore të së cilës është shkëmbimi i eksperiencave në mësimdhënie, kërkim shkencor, projekte apo programe të përbashkëta, këto elementë janë nxitur dhe mbështetur fare pak nga strukturat drejtuese, ose me keq akoma, nuk është bërë pothuajse asgjë për jetësimin e tyre.



•**Qëndrimi i drejtuesve ndaj pjesëmarrjes së pedagogëve në veprimtaritë shkencore.** Ndonëse pjesëmarrja në konferenca, projekte e botime shkencore ka qenë shpallur si një gjë e dëshirueshme dhe e dobishme për pedagogët dhe vetë universitetin apo studentët, pedagogët jo vetëm që nuk janë stimuluar financiarisht, por shpesh, janë penguar edhe administrativisht.



•**Reduktimi dhe shtrembërimi i lirisë akademike të pedagogut.** Ndonëse esenca e lirisë akademike të pedagogut qëndron në të drejtën dhe përgjegjësinë e pedagogut në formatimin e programit mësimor, menaxhimin e lëndës dhe veprimtarive që lidhen me procesin mësimor dhe vlerësimin e studentëve, në orientimin e kërkimit shkencor individual dhe integrimin e tij në procesin mësimor dhe interesat e studentëve, nuk janë të rralla rastet kur marrëdhënia e pedagogut me departamentin dhe fakultetin, reduktohet në orën që ai vjen ose ikën nga ndërtesa, me orët që ai qëndron i ngujuar në zyrë para kompjuterit, apo në llogaritjen e orëve të dhëna ose jo mësim.

•**Raportet e zhdrejta pedagog-studentë.** Ndonëse cilësia e mësim dhënies varet në një masë të konsiderueshme nga numri i pedagogëve në dispozicion të studentëve, numri i pedagogëve në Universitetin e Tiranës vazhdon të jetë jo proporcional me numrin e studentëve. Përballë presionit dhe rritjes së numrit të studentëve dhe programeve akademike, mosrritja e numrit të pedagogëve, ka çuar në mbingarkesën e tyre, mbipopullim të auditorëve dhe rënies së cilësisë së mësimdhënies.



•**Praktikimin e rekrutimeve herë-herë të bazuar jo në meritë, por në preferenca dhe favore klienteliste.** Ndonëse cilësia e mësim dhënies, bashkë me përgatitjen dhe formimin e studentit, varet në një masë të madhe nga cilësia e përgatitjes dhe formimit të pedagogut në auditor, në Universitetin e Tiranës vazhdojnë të përdoren praktika që e konsiderojnë punësimin e pedagogëve si formë të bërjes së ndereve, shpërblimit, apo edhe përfitimeve financiare personale, në këmbim të punësimit.

•**Mungesën e vlerësimit sistematik të punës së një pedagogu brenda departamentit, fakultetit, universitetit.** Ndonëse vlerësimi sistematik i çdo pedagogu do të kontribuonte jo vetëm në cilësinë e mësimdhënies, por edhe në evidentimin dhe shpërblimin e pedagogëve më të mirë, fakultetet apo departamentet në Universitetin e Tiranës nuk praktikojnë vlerësimin e punës së pedagogëve. Nuk ka një databasë të vlerësimeve të bëra nga studentët ndër vite, të krahasimit të performancës së pedagogëve në rang departamenti, fakulteti apo universiteti, për semestër, vit akademik apo ndër vite. Ndaj sot, është e vështirë të thuhet se cilët janë pedagogët më të mirë, ata mesatarë apo ata që kanë nevojë për trajnim.

4.2 Problemet me POLITIKAT dhe TRAJTIMIN E STUDENTËVE.

Në këtë aspekt, kjo platformë mban parasysh përballjen me këto probleme të trashëguara:

•**Problemët me kriteret dhe procedurat e pranimit.** Procesi dhe kriteret e pranimit të studentëve vazhdojnë të mbeten problematike në të tre ciklet e studimeve universitare. Ndonëse Universitetit të Tiranës i lihet dorë e lirë në përcaktimin e kriterëve, shpesh këto kriterë në vend që të përcaktohen nga universiteti, përcaktohen nga MAS.

•**Problemët me trajtimin financiar të studentit.** Megjithëse është folur shumë për tarifat dhe krijimin e lehtësive për studentët, tarifimi i tyre vazhdon me të njëjtën mendësi dhe praktika, që karakterizohen nga pandjeshmëria ndaj fuqisë dhe gjendjes ekonomike të studentit. Edhe përsa i përket ndihmës financiare për studentin, realizimi i një premtimi të tillë ose është reduktuar në disa forma dhe nivele minimale, ose është neglizhuar.

•**Problemët me të drejtat e studentëve.** Ndonëse studentëve iu është njohur e drejta e përfaqësimit në strukturat drejtuese të universitetit; e drejta e shprehjes së lirë dhe e organizimit në shoqata apo organizata studentore; ndonëse studentët konsiderohen një vlerë e shtuar dhe kontribues në garantimin e cilësisë së mësimdhënies, programeve akademike dhe jetës së universitetit në përgjithësi, ata mbeten të përfaqësuar formalisht dhe shpesh grupimet studentore përdoren dhe manipulohen për interesa të caktuara.

•**Formalizëm me praktikat profesionale dhe perspektivën studentore për karrierë.** Ndonëse praktikat profesionale dhe mundësitë për punësim dhe karrierë janë dy interesa jetike për studentin, këto vazhdojnë të mbeten në rastin më të mirë fiktive dhe jo eficiente, dhe në rastin më të keq inekzistente.

4.3 Problemët me cilësinë e MËSIMDHËNIES dhe funksionimin e PROGRAMEVE AKADEMIKE.

Në aspektin kryesor të veprimtarisë akademike të Universitetit të Tiranës, kjo platformë mban parasysh përballjen me këto probleme:



•**Problemët me hapjen, mbylljen, fillimin dhe mbarimin e programeve dhe sezonit akademik.** Problemi më i zakonshëm është shtyrja e herëpashershme e datës së fillimit të vitit akademik, sidomos për ciklin e dytë, sipas diktatit të MAS, duke cenuar autonominë akademike të Universitetit të Tiranës.

•**Problemët me cilësinë, vlerësimin, freskimin dhe përshtatjen e kurrikulave me tregun mbi të cilat funksionojnë programet akademike.**

Ky problem vazhdon të mbetet problem i prekshëm dhe pa mbështetje nga Rektorati, në pikëpamje të ndihmës me specialistë kurrikulash dhe fonde në dispozicion të këtij procesi. Veç kësaj, kurrikulat e programeve akademike që ofron Universiteti i Tiranës, kanë nevojë jo vetëm për përmirësim dhe përshtatje të tyre me nevojat e studentëve, tregut, ekonomisë dhe shoqërisë, por edhe për pasurim të tyre me kurrikula të reja.

•**Ngrirjen e programeve dhe studimeve doktorale.** Ndonëse Universiteti i Tiranës është universiteti më i madh në Shqipëri, ndonëse ai disponon staf akademik, që mund të realizojë si numër studimet doktorale; ndonëse pedagogë të tij udhëheqin doktorata edhe jashtë Universitetit të Tiranës, përpjekjet e drejtuesve për të ndryshuar këtë gjendje kanë qenë të pamjaftueshme. Është fakt që Universiteti i Tiranës nuk merr kuotat që ka propozuar vetë që në vitin akademik 2013-2014, ndërkohë që ka një qasje tjetër të MAS ndaj universiteteve jo publike.

4.4 Problemët me politikat dhe kryerjen e KËRKIMIT SHKENCOR.

Lidhur me komponentin e dytë, shumë të rëndësishëm për një universitet, kjo platformë mban parasysh përballjen me këto probleme të trashëguara:

•**Mbështetjen e pamjaftueshme financiare të kërkimit shkencor.**

Ndonëse kërkimi shkencor është komponenti kryesor i një universiteti dhe mbështetës e kontribues në cilësinë e mësimdhënies, Universiteti i Tiranës nuk ka vënë ndonjëherë në dispozicion fonde për mbështetjen dhe stimulimin e konferencave, botimeve, projekteve apo veprimtarive shkencore, të ndërmarra qoftë nga pedagogë individualisht, qoftë nga departamentet apo fakultetet.

•**Neglizhimin e përgjegjësisë për krijimin e kushteve stimuluese**

për veprimtari dhe kërkim shkencor. Ndonëse Universiteti i Tiranës pretendon që është universiteti më i vjetër, më i madh, me trupë akademike nga më cilësoret, përsëri Universiteti i Tiranës nuk ka asnjë Revistë Shkencore të vetën, asnjë Shtëpi Botuese, siç kanë mjaft universitete serioze dhe as ambiente të tjera stimuluese dhe nxitëse për mbajtjen e aktiviteteve të mëdha shkencore kombëtare e ndërkombëtare.

4.5 Probleme me POLITIKAT FINANCIARE të Universitetit.

Në këtë aspekt kjo platformë mban parasysh përballjen me këto praktika dhe probleme të trashëguara nga qeverisjet e mëparshme të universitetit:

- **Diversitetin e varfër të burimeve financiare të universitetit.** Buxheti i Universitetit të Tiranës furnizohet nga fondet që alokon qeveria dhe nga të ardhurat e studentëve. Universiteti i Tiranës mbetet ende i varur nga këto dy burime dhe nuk ka arritur të sigurojë të ardhura edhe nga burime të tjera si: shërbime për të tretët, donatorë kombëtarë apo ndërkombëtarë, projekte dy apo shumëpalëshe.

- **Problemët me procedurat e hartimit.** Hartimi i buxhetit vazhdon të mos arrijë dot rakordimin mes nevojave të funksionimit e zhvillimit të tij dhe disponueshmërisë së fondeve. Praktika e deritanishme e hartimit të buxhetit është ajo nga lart-poshtë, d.m.th. buxheti hartohet nga strukturat e sipërme, shpesh pa mbajtur në vëmendje nevojat e bazës dhe iu imponohet strukturave të poshtme, në fakultet apo departament, në mënyrë apriori.

- **Problemët me transparencën e vendim-marrjes dhe mekanizmat e kontrollit, verifikimit dhe llogari-dhënies, për shpërndarjen dhe përdorimin e fondeve.** Përcaktimi dhe shpërndarja e burimeve financiare vazhdon të mos jetë transparente, por e kufizuar në duarte Rektoratit apo nganjëherë edhe të Dekanëve. Mbi të gjitha, vendimet e marra as mbulohen, as shoqërohen me funksionimin e mekanizmave të kontrollit, verifikimit dhe kërkimit të llogarisë për përdorimin e fondeve dhe efektivitetin e tyre.

4.6 Problemet me INFRASTRUKTURËN fizike dhe virtuale, si dhe me FUNKSIONIMIN ADMINISTRATIV të saj

Në këtë aspekt, kjo platformë mban parasysh gjendjen jo komode dhe një numër problemesh të pazgjidhura, ose të zgjidhura pjesërisht:

•**Mungesa e sistemeve teknologjike virtuale të komunikimit dhe të informimit.** Universiteti i Tiranës vazhdon të ekzistojë kryesisht vetëm në dimensionin fizik. Ndonëse është folur për futje të teknologjisë në Universitetin e Tiranës, dimensionin virtual i tij është mungesor ose i reduktuar vetëm në ofrimin e disa shërbimeve të pjesshme për studentët. Nëse dikush nga brenda apo jashtë Shqipërisë, do të kërkonte elektronikisht informacion për Universitetin e Tiranës, ai nuk do të gjente informacion të mjaftueshëm dhe të plotë për universitetin, fakultetet, departamentet, programet apo të dhënat akademiko-profesionale të drejtuesve dhe pedagogëve; ai nuk do të mund të kryente nga distanca, elektronikisht, veprime të tilla si: regjistrim, pagesa apo komunikim; ai nuk do të gjente të publikuar dhe të aksesonte lirshëm informacion dhe dokumente për qeverisjen dhe strukturat e universitetit, funksionimin akademik, financiar, dhe administrativ të tij.



•**Ndërtesa dhe ambientet problematike, të pamirëmbajtura, të keqkonceptuara.** Në Universitetin e Tiranës, të vetmet ndërtesa që funksionojnë janë: bibliotekat fizike (bibliotekat virtual mungojnë), konviktet studentore, si dhe disa qendra shërbimesh akademike dhe jo akademike për studentët. Pavarësisht destinacionit, shumica e tyre ose keqadministrohen, ose janë shumë larg standardeve të një universiteti që pretendon elitarizëm dhe emër.



• **Problemët me bazën materialo-didaktike të mësimdhënies.** Në një pjesë të konsiderueshme të departamenteve dhe instituteve studimore mungojnë pajisjet mësimore-teknologjike, për të zhvilluar leksione të nivelit të dëshirueshëm bashkëkohor si: projektorët, kompjuterët etj.

• **Politikat dhe trajtimi i stafit administrativ.** Ndonëse stafi administrativ përbën një ndër segmentet dhe faktorët kyç në funksionimin e përditshëm të universitetit, shpesh nevojat dhe të drejtat e këtij stafi, për sigurinë dhe kushtet në punë apo për sigurimin shëndetësor, janë neglizhuar në mënyrë të vazhdueshme.

4.7 Problemët me ZHVILLIMIN STRATEGJIK dhe NDËRKOMBËTARIZIMIN.

Në këtë aspekt, kjo platformë mban parasysh një numër problemesh dhe premtimesh të pambajtura nga qeverisja e mëparshme e Universitetit të Tiranës:

• **Mungesa e formave të bashkëpunimit** (Memorandums of Cooperations) dhe binjakëzimit me universitete, fakultete dhe institute kërkimore-shkencore europiane dhe perëndimore. Këto projekte binjakëzimi ose kanë munguar, ose kanë ekzistuar vetëm në letër, por pa gjetur implementim.

• **Mungesa e diplomave apo çertifikatave të përbashkëta** me programe mësimore të universiteteve të rajonit, europiane dhe perëndimore.

• **Mungesa e ftesave dhe vizitave të pedagogëve e studiuesve** të shquar europiane e perëndimore në formë “guest lecturers”, për cikle leksionesh, leksione të hapura (public lectures) apo Konferenca dhe Kongrese shkencore.

- Mungesa e mobilitetit për pedagogët dhe studentët.** Një nga drejtimet e bashkëpunimit me universitetet e huaja është edhe mobiliteti i studentëve dhe pedagogëve shqiptarë, si në formën e study-visits të pedagogëve shqiptarë në universitete europiane e botërore, të ndjekjes së cikleve të shkurtra të studimit të studentëve shqiptarë në universitete jashtë apo ardhja e studentëve të huaj në Universitetin e Tiranës, në formën e “exchange programmes”, të cilat kanë qenë pothuaj inekzistente.

- Mungesa e vlerësimit dhe akreditimit të programeve akademike nga agjenci ndërkombëtare.** Universiteti i Tiranës vazhdon të funksionojë vetëm me programe të akredituara nga Ministria e Arsimit.

- Renditja në rangjet më të ulëta në listën e universiteteve europiane apo botërore.** Ndonëse Universiteti i Tiranës vlerësohet si më i miri mes universiteteve shqiptare, në rrafshin europian dhe botëror Universiteti i Tiranës nuk arrin të renditet në asnjë listë universitetesh serioze, nga mosplotësimi me kriteret dhe standardet e rankimeve.

4.8 Problemet në MARRËDHËNIET MES STRUKTURAVE DREJTUESE TË UNIVERSITETIT.

Në këtë aspekt të funksionimit dhe veprimtarisë së Universitetit të Tiranës, kjo platformë mban parasysh përballjen me këto probleme:

- Mungesën e transparencës në marrjen e vendimeve.** Ky problem ka karakterizuar marrëdhëniet mes Rektoratit dhe Senatit, Dekanateve dhe Departamenteve për vendimet rreth menaxhimit dhe shpërndarjes së të ardhurave, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe funksionimit të programeve akademike.

- Mungesën e bashkëpunimit, ose praktikimin e bashkëpunimit preferencial dhe selektiv.** Këto praktika janë zbatuar si në linjën vertikale, ashtu edhe në atë horizontale.

- Defaktorizimin, ose manipulimin e rolit dhe ndikimit të Këshillave Akademike.** Roli dhe ndikimi i Këshillave Akademik në vendimet e Rektoratit ka qenë ose minimal, ose i papërfillshëm.

- Injorimi në vendimmarrje i nevojave dhe interesave të pedagogëve dhe studentëve.** Në vendimet e veta, Rektorati, në mënyrë të përsëritur, ka injoruar kërkesat dhe sugjerimet e paraqitura nga Senati Akademik,

Këshillat Akademike, Dekanët e Fakulteteve, Shefat e Departamenteve, pedagogë të thjeshtë apo grupe studentore.

5. ÇFARË PROJEKTI OFRON KONKRETISHT KJO PLATFORMË PËR 4 VITET E ARDHSHE?

Projekti që ofron kjo platformë ngrihet mbi një model dhe viziondrejtimi të Universitetit të Tiranës krejt të ndryshëm nga modeli dhe mendësia e drejtuesve të mëparshëm. Ai ofron ndërmarrjen e veprimeve konkrete në:

- Politikat akademike
- Veprimtarinë financiare
- Funksionimin administrativ
- Zhvillimin strategjik të universitetit
- Ndryshimin dhe demokratizimin e modelit të qeverisjes së brendshme dhe marrëdhënieve mes strukturave drejtuese të universitetit

Ky projekt i jep përparësi zgjidhjes së problemeve dhe realizimit të ndryshimeve në tre drejtime kryesore:

- Në trajtimin e pedagogëve, studentëve, mësimdhënies, programeve akademike dhe kërkimit shkencor;
- Në zhvillimin strategjik dhe ndërkombëtarizimin e Universitetit të Tiranës;
- Në demokratizimin e qeverisjes së brendshme dhe marrëdhënieve institucionale, mes strukturave të universitetit dhe drejtuesve të tyre.

5.1 Për Trajtimin e Pedagogëve.

Kjo platformë ofron këto nisma ndryshimi:

- Aplikimin e Statusit të Pedagogut.** Ky status do konsistojë në përcaktimin e disa specifikave akademike të statusit të pedagogut; do të mbrojë pedagogun nga arbitrariteti, padrejtësitë dhe qëndrimet subjektive të drejtuesve.
- Punësimi të përcaktuar mbi bazën e kritereve profesionale.** Ndryshimi do të konsistojë në kalimin e vendimarrjes në kompetencë të Departamentit; zvogëlimin në vendimarrje të ndikimeve jashtë-departamentale; mos

përfshirjen në komision të individëve me kredenciale profesionale më të ulëta, në raport me ato të kandidatëve; kryerjen e punësimit mbi bazën e meritave, dosjes akademike të kandidatëve, nevojave të programit dhe jo në bazë të “kriterëve”, që vendosen të tilla, që të garantojnë punësimin e një personi të paracaktuar; si dhe krijimin dhe garantimin e funksionimit eficient të mekanizmave të brendshëm kontrollues dhe verifikues të transparencës, korrektësisë dhe profesionalizmit të procesit rekrutues dhe vendimit.

•**Ndryshimin e Modelit të Pagesës dhe Shpërblimeve për Pedagogët.**

Do të këmbëngulet, pasi të bëhet një studim i detajuar dhe i mirë argumentuar për rritjen e pagës së pedagogëve dhe të stafit administrativ, duke iu përafruar të paktën nivelit të pagave në Republikën e Kosovës (paga më e ulët është 1000 euro), si dhe duke nxitur pagesën e të gjitha aktiviteteve, që aktualisht janë të papaguara (komisionet, udhëheqjet e masterave, komisionet e doktoraturave etj.). Këtu theksojmë edhe propozimin e kolegëve të Universitetit të Tiranës, për rritjen e pagesës së orës mbi normë: 3000 Lekë për leksionet dhe 2000 Lekë për seminarët.

•**Reduktim të Ngarkesës Mësimore.** Ky ndryshim ka lidhje dhe vjen si rezultat i përmirësimit të kriterëve të punësimit, rritjes së numrit të pedagogëve të punësuar, si dhe ndryshimit të raportit student/pedagog.

•**Evidentim të Pedagogëve më të Mirë.** Ky element i ri ka të bëjë me aplikimin e vlerësimeve për pedagogun më të mirë, në bazë të vlerësimeve të mbledhura nga studentët në fund të semestrit dhe përfundimit të lëndës. Pedagogët do të vlerësohen përmes krahasimit të rezultatit të tyre për një semestër, vit akademik apo disa vite akademike, midis tyre, në rang departamenti, fakulteti dhe universiteti. Në fund të çdo viti akademik, departamentet, fakultetet, dhe universiteti do të evidentojnë dhe japin çmimin për tre pedagogët më të mirë, që renditen në vendin e parë, të dytë dhe të tretë.

•**Respektim të Lirisë Akademiko-Profesionale të Pedagogut.**

Ndryshimi konsiston në heqjen dorë nga barazimi i “të qenët në rregull” nga ana e pedagogut me rregullat burokratike dhe ligjet, me ardhjen apo jo fiks në orën 8 në fakultet dhe qëndrimin e pedagogut 8 orë fiks në ambientet e departamentit, fakultetit apo universitetit. Në vend të kësaj praktike të dikurshme, do të kryhet me kritere të tjera të veprimtarisë dhe prodhimit akademike - ngarkesën mësimore, punën kërkimore dhe

botimet, plotësimin e detyrimeve burokratike në departament, fakultet apo universitet, si dhe me plotësimin e detyrimeve të tij ndaj studentëve dhe programit mësimor.

5.2 Për Trajtimin e Studentëve. Kjo platformë ofron këto iniciativa ndryshimi:

•**Ndryshim në Politikat e Universitetit për Kriteret e Pranimit të studentëve.** Ndryshimet që ofrohen në këtë platformë kanë të bëjnë me mesataren e pranimi në nivelin Bachelor dhe kriterin e gjuhës së huaj në nivelin Master. Mesatarja e pranimi lihet në kompetencën e fakulteteve dhe departamenteve për t'u përcaktuar, por do të konsiderojë të pranueshëm çdo student që ka një mesatare 6.00 e sipër. Po ashtu, provimi i gjuhës së huaj do të jetë njëkusht i domosdoshëm vetëm për ciklin e tretë (studimet doktorale) dhe Masterin Shkencor, ndërsa në nivelin Master Profesional do të lihet në dëshirën e studentit dhe do të konsiderohet kusht fakultativ.



•**Ndryshime në Politikat e Tarifimit të Studentit.** Ndryshimi synon të mos rrisë tarifat dhe pagesat studentore, të ulë tarifat aty ku është e mundur, nëse është e mundur, pas një transparence të të ardhurave, shpërndarjes dhe shpenzimit të buxhetit të universitetit, si dhe të pranojë pagesë me këste të tarifave.



•**Krijimin e Zyrave Akademike Studentore në ndihmë të Studentëve.** Këto zyra do të ngrihen pranë fakulteteve, do të vihen në punë nga studentë, do të angazhojnë studentët më të mirë dhe do të shërbejnë për të ndihmuar studentët e tjerë, për të kapërcyer mangësitë e ndryshme në aftësitë shkruese, gjuhësore, aftësitë analizuese të teksteve, kryerjen

e kërkimit për gjetje të materialeve që kanë lidhje me lëndën, detyrat dhe procesin mësimor, si dhe dhënie ndihme, për kryerjen e detyrave të kursit.

•**Praktikimin dhe Dhënien e së Drejtës Studentit për vlerësimin e Pedagogut.** Ndryshimi konsiston në marrjen mendimit të studentëve për pedagogët që u japin mësim. Mendimi i tyre merret përmes një pyetësori standard, që plotësohet me vlerësim të përshkallëzuar numëror “Likert” dhe komente gjuhësore, i cili mund të plotësohet me emër dhe mbiemër, ose në mënyrë anonime. Të dhënat e pyetësorëve përpunohen në fakultet dhe vlerësimi për pedagogun, pas dokumentimit në sekretari, i jepet pedagogut të lëndës, për ta vënë në dijeni dhe për t’i dhënë mundësi të bëjë ndryshime në mësimdhënie, nëse del e nevojshme, në semestrin e ardhshëm.

•**“Dekani” i Studentëve.** Mbështetjen e krijimit dhe funksionimit të pozicionit të “Dekanit” të trupës studentore nëpër fakultete. Ky përfaqësues duhet të zgjidhet nga studentët dhe duhet të shërbejë si përcjellës i shqetësimeve, i problemeve akademike dhe studentore të studentëve individualë ose grupeve studentore, pranë dekanatit.

•**Krijimin e Mundësisë për Studentët të Ndjekjes së Shkollave Verore.** Ndryshimi synon të ndihmojë studentët të avancojnë në kryerjen e lëndëve që konsiderohen të domosdoshme nga programi akademik dhe mbledhjen e krediteve të nevojshme, për përfundimin e studimeve në nivelin Bachelor.

•**Krijimin e Lehtësirave në jetën Urbane për Studentët.** Kjo përfshin angazhimin e universitetit në paraqitjen e një kërkese Bashkisë së Tiranës, për të mundësuar akses lehtësuese për studentin përsa i përket transportit publik (pajisjes me abone) apo frekuentimit të institucioneve social-kulturore, me çmime të reduktuara (teatër, kinema, stadium, ekspozita, panairë etj.)

•**Krijimin e mjediseve çlodhëse, rekreative dhe sportive për studentët.** Kjo përfshin angazhimin e plotë, në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Edukimit fizik të UT-së, mbi hartimin e një strategjie në lidhje me mirëfunksionimin e modulit “Sporte” në programet e studimit si edhe në organizimin e aktiviteteve të ndryshme sportive në rang fakulteti dhe Universiteti.

5.3 Për Mësimdhënien dhe Programet Akademike.

Kjo platformë ofron këto iniciativa ndryshimi:

- **Rifillimin e programeve doktorale.** Kjo platformë synon të rifillojë studimet doktorale. Për realizimin e kësaj do të identifikohen kapacitetet profesionale që garantojnë funksionim normal, ambiente të nevojshme, si dhe programet dhe projektet shoqëruese të studimeve doktorale.

- **Krijimin e Programeve të përbashkëta dhe ndërdisiplinore.** Ajo që synon kjo platformë është aplikimi në Universitetin e Tiranës i programeve të përbashkëta mes fakulteteve apo mes Universitetit të Tiranës dhe universiteteve të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë; po ashtu, synon edhe aplikimin e programeve që ngërthejnë një ose disa disiplina dhe ofrojnë një formim, përgatitje, dhe perspektivë të re për studentin.

- **Vënien në funksionim të Programeve të Posaçme të Kualifikimit për Grupe Specifike.** Kjo platformë konsideron se ofrimi nga Universiteti i Tiranës i programeve kualifikuese për grupe specifike (mësuesve të cikleve të arsimit fillor, dhe para universitar) paraqet një mundësi të mirë për Universitetin e Tiranës, grupet specifike dhe vetë shoqërinë, qoftë nga pikëpamja e cilësisë së kualifikimeve, qoftë nga pikëpamja e kostos dhe e të ardhurave, që krijohen nga ofrimi i shërbimeve të tilla.

- **Ngritjen e grupeve të punës në nivel rektorati, fakulteti dhe departamenti për vlerësimin dhe freskimin e kurrikulave.** Kjo platformë e konsideron të rëndësishme rivitalizimin dhe përshtatjen e programeve dhe kurrikulave akademike, me tregun dhe nevojat e studentit dhe të shoqërisë.

- **Ngritjen e njësisë së Trajnimit për Mësimdhënie të Pedagogëve.** Kjo Platformë e konsideron mjeshtërinë dhe eksperiencën mësimdhënëse të pedagogut, një faktor mjaft të rëndësishëm influencues në cilësinë e mësimdhënies dhe të formimit profesional të studentit. Kjo njësi do të ofrojë trajnim të vazhdueshëm të pedagogëve.

5.4 Për Kërkimin Shkencor.

Kjo platformë ofron këto iniciativa ndryshimi:

- **Sigurimin e fondeve mbështetëse për Kërkimin Shkencor.** Kjo platformë konsideron se ndryshimet dhe rritja e cilësisë dhe gamës së kërkimit dhe veprimtarisë kërkimore-shkencore në Universitetin

e Tiranës, nuk mund të ndodhin pa garantimin e fondeve, që do të stimulonin dhe mbështesnin financiarisht pjesëmarrjen dhe angazhimin e pedagogëve në konferenca, kongrese, kërkim shkencor individual, botime individuale apo grup, qendra kërkimore pranë fakulteteve dhe departamenteve, projekte brenda apo jashtë Shqipërisë. Fondet mbështetëse synohet të bëhen të disponueshme për të gjithë ata pedagogë apo grupe pedagogësh, të cilët do mund të paraqesin skicat dhe objektivat e kërkimit apo aktivitetit shkencor që kanë planifikuar dhe që vlerësohen si të denja për t'u financuar.

•**Stimulimi dhe mbështetja e Qendrave Kërkimore në rang Fakulteti apo Departamenti.**

Krijimi i “Qendrave të kërkimit shkencor dhe projekteve” në rang UT dhe çdo fakulteti (aty ku është e mundur edhe në rang departamenti). Kjo platformë e konsideron të rëndësishme ngritjen dhe mbështetjen e qendrave të tilla kërkimore, të cilat do të krijojnë kushte për zhvillimin dhe nxitjen e projekteve shkencore si dhe të bashkëpunimit midis kolegëve dhe studiuesve. Kjo platformë parashikon mbështetje të pjesshme logjistike dhe financiare për çdo qendër kërkimore, që do të ngrihet pranë fakulteteve apo departamenteve.

•**Nxjerrja e një reviste shkencore të Universitetit të Tiranës.** Kjo platformë konsideron se themelimi i një reviste shkencore, me bord editorial dhe praktika botimi të ngjashme me ato që ndiqen nga universitetet më të mira Europiane, ndikon në përmirësimin e imazhit të Universitetit të Tiranës përsa i përket veprimtarisë shkencore, në nxitjen e kërkimit shkencor në Universitetin e Tiranës, si dhe një angazhim më të madh të vetë pedagogëve.

•**Ngritja e Shtëpisë Botuese të Universitetit të Tiranës.** Edhe ngritja e shtëpisë botuese të Universitetit të Tiranës shihet në funksion të nxitjes së prodhimit shkencor dhe përmirësimit të kushteve dhe mundësive për botim, uljes së kostove të librave, që do të çojë në uljen e çmimeve të përbalueshme nga studentët.

•**Aplikimi i “Sabbatical”.** Kjo platformë konsideron se Universiteti i Tiranës duhet të përqafojë praktikën më të mirë të universiteteve nëpër botë, përsa i përket stimulimit dhe mbështetjes së prodhimit shkencor të pedagogëve. Praktikimi i “Sabbatical”, dhënies leje të paguar një pedagogu, për t'u marrë dhe për të përfunduar një

projekt kërkimor shkencor, hyn në këtë pozicionim dhe kjo platformë e sheh si një ndër rrugët e stimulimit të pedagogëve të Universitetit të Tiranës, për t'u angazhuar në projekte dhe studime shkencore.

5.5 Për Ndërkombëtarizimin.

Kjo platformë ofron këto iniciativa ndryshimi:

• **Nxitjen e Mobilitetit Akademiko-Profesional të pedagogëve.** Kjo platformë konsideron se mobiliteti është një nga burimet e rritjes së reputacionit ndërkombëtar të Universitetit të Tiranës. Ndaj, platforma synon të identifikojë të gjithë mundësitë që ekzistojnë për mobilitet të pedagogëve dhe studentëve, në rajonin e Ballkanit apo në universitetet e hapësirës Europiane.

• **Akreditimin e programeve akademike të veçanta dhe të të gjithë universitetit, si institucion akademik.** Platforma konsideron se akreditimi ka të bëjë me shkallën e seriozitetit akademik të një institucioni, ndaj dhe krijimi i kushteve për vlerësimin dhe akreditimin e Universitetit të Tiranës, i shërben rritjes së seriozitetit dhe reputacionit të këtij universiteti brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Albania

ranking	World Rank 	University	Det.	Presence Rank*	Impact Rank*	Openness Rank*	Excellence Rank*
1	5804	University of Tirana / Universiteti i Tiranës		8564	10321	5589	3960

• **Pjesëmarrje efektive në programet dhe projektet e BE-së për universitetet dhe arsimin e lartë.** Kjo platformë synon që pjesëmarrja e Universitetit të Tiranës në projekte ndërkombëtare, të financuar dhe mbështetur nga BE, ka ardhur koha të dalë nga korniza e formalizmit dhe të shndërrohet në një komponent të rëndësishëm, jo vetëm të nxitjes së kërkimit shkencor, por edhe reputacionit ndërkombëtar të vetë Universitetit.

• **Pasurim programesh në nivelin Master që zhvillohen në Anglisht.** Kjo platformë konsideron se përthithja nga Universiteti i Tiranës i studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimi i tij, nuk do të mund të arrihet, pa zhvillimin e programeve Mastër në anglisht. Një gjë ë tillë, jo vetëm do të stimulonte tek studentët shqiptarë interesin për anglishten, por edhe do

të përmirësonte cilësinë e programeve Master në Universitetin e Tiranës dhe vetë imazhin ndërkombëtar të tij.

5.6 Për Infrastrukturën dhe teknologjinë.

Kjo platformë synon jetësimin e një numri projektsh:

- **Aplikimin e Teknologjisë Virtuale të Komunikimit.** Universiteti i Tiranës vazhdon të funksionojë dhe prezantojë qenësinë e vet vetëm në dimensionin fizik. Kjo platformë hedh sytë nga dimensionin virtual i ekzistencës dhe prezantimit të Universitetit të Tiranës dhe konsideron se aplikimi i teknologjisë së komunikimit dhe informacionit (TIK) në biblioteka; se zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të tilla virtuale të komunikimit si: Blackboard apo Webpage, jo vetëm lehtëson vendosjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve mes universitetit, studentit dhe publikut në masë, por edhe rrit kredibilitetin e Universitetit të Tiranës, duke e vendosur atë në radhën e universiteteve më serioze në Europë.

- **Salla Leksionesh me teknologji komunikimi dhe informacioni (TIK).** Kjo platformë konsideron se mësimdhënia është cilësore dhe efektive, kur ajo kombinon aftësitë pedagogjike të pedagogut me disponueshmërinë dhe përdorimin e teknologjisë së komunikimit. Ndaj, në kushtet kur mjaft salla leksionesh në Universitetin e Tiranës nuk janë të pajisur me TIK, kjo platformë synon të rrisë numrin e sallave, në të cilat procesi mësimor zhvillohet me ndihmën dhe përdorimin e teknologjisë së komunikimit dhe informacionit (TIK).



- **Shtim të Numrit të Sallave për Leksione.** Kjo platformë konsideron se cilësia e mësimdhënies, efektiviteti i procesit mësimor, si dhe kultivimi i studentëve me formim të shëndoshë, varet në një masë të konsiderueshme nga numri i studentëve të pranishëm në sallat e leksioneve. Ndaj, kjo platformë synon të bëjë “normë” akademike kurse studentësh, me jo më shumë se 30 vetë.

5.7 Për Politikat dhe Praktikak Financiare.

Kjo platformë ofron këto iniciativa ndryshimi:

- **Diversifikimin e Burimeve të të Ardhurave.** Kjo platformë beson se të ardhurat nga buxheti i qeverisë dhe studentët janë të mjaftueshme për të mbijetuar, por jo për t'u zhvilluar drejt shndërrimit në një universitet serioz. Prandaj kjo platforme synon të diversifikojë dhe zgjerojë financimin e buxhetit të Universitetit të Tiranës edhe me burime të tjera, që e kanë origjinën në vëzhgimin e tregut dhe trendeve të tij, në stimulimin e interesit të donatorëve privatë, në pjesëmarrjen në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, në shërbime ndaj të tretëve.

- **Transparencë, kontroll, llogaridhënie, verifikim në hartimin, shpërndarjen dhe përdorimin e fondeve.** Kjo platformë beson se pa aplikimin e transparencës në funksionimin financiar të universitetit, nuk mund të ketë shpërndarje, përdorim dhe menaxhim efektiv të tyre. Andaj kjo platformë thekson si mjaft të rëndësishme angazhimin në marrëdhënie transparence midis strukturave drejtuese të universitetit dhe drejtuesve të tyre.

5.8 Për Demokratizimin e modelit të Qeverisjes dhe Marrëdhëniet Institucionale brenda Universitetit.

Kjo platformë ofron këto iniciativa ndryshimi:

- **Transparencë dhe përgjegjësi në vendimmarrje.** Kjo platformë konsideron se: Universiteti i Tiranës nuk do të mund të ecë përpara, pa transparencën e strukturave drejtuese për vendimet e marra dhe marrëdhëniet që krijojnë mes njëra-tjetrës strukturat qeverisëse.

- **Disponueshmëri të dokumentacionit.** Kjo platformë beson se një ndër indikatorët tregues të seriozitetit të një universiteti është aksesit dhe disponueshmëria e dokumenteve që qëndrojnë në bazë të ndarjes së autoritetit dhe pushtetit, marrëdhënieve mes strukturave drejtuese, si dhe marrëdhënieve të universitetit me individë student, prind, apo pedagog, si dhe marrëdhëniet me institucione dhe aktorë brenda apo jashtë vendit. Për të gjitha shqetësimet e përbashkëta, si dhe për të gjitha propozimet e vëna para jush, ju ftoj të krijojmë një frymë dhe shpresë të re, për rivitalizimin dhe vendosjen e Universitetit të Tiranës në piedestalin që i takon.





Bashkohuni me projektin që ofron kjo platformë dhe votoni për të!



Bazuar në ruajtjen e vlerave të përfuara deri më tani në fushat e drejtimit,

- Të procesit mësimdhënies e mësimnxënies
- Të kërkimit shkencor
- Të autonomisë financiare
- Të autonomisë institucionale

ftoj pedagogët dhe studentët e Universitetit të Tiranës t'i bashkohen vizionit tim për një universitet të hapur, me frymë e standarte bashkëkohore.

OTO